ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS-FABREFACTA-OPTIME

MANUAL PËR REALIZIMIN E PROCESIT MËSIMOR NË DISTANCË (*ONLINE*) NË "*ALBANIAN UNIVERSITY*" PËR VITIN AKADEMIK 2020 - 2021

I.HYRJE

Qëllimi kryesor i këtij manuali është të mbështesë dhe rregullojë realizimin me cilësi të procesit mësimor në distancë (*online*) në "*Albanian University*", gjatë periudhës së pandemisë COVID - 19. Procesi mësimor në distancë konsiston në hartimin, zhvillimin dhe shpërndarjen e të gjitha aktiviteteve mësimore përmes platformave *online*. Procesi mësimor në distancë duhet të shërbejë edhe për të lehtësuar situatën psikologjike të studentëve në kushtet e pandemisë.

II. REALIZIMI I PROCESIT MËSIMOR

2.1 Platforma online

- Në "*Albanian University*" për realizimin e procesit mësimor në distancë (*online*) përdoret platforma "*Microsoft Teams*".
- Procesi mësimor zhvillohet sipas orarit të miratuar nga Fakultetet në "Albanian University". Studentët informohen paraprakisht për çdo ndryshim eventual të orarit mësimor, në kushtet e zhvillimit të mësimit në distancë.

2.2 Realizimi i leksioneve

- Leksionet organizohen në bazë klase virtuale, në çdo program studimi, në nivelet *Bachelor, Master i Shkencave, Master Profesional dhe Specializime Afatgjata në fushën e Stomatologjisë* si më poshtë:

a) Leksionet zhvillohen në kohë reale me "*Video Call*" nga lektori/ët e lëndës dhe shoqërohen me materiale të tjera mësimore, të cilat paraqiten në platformë, në format *power point* (ppt.) apo pdf.
b) Leksionet zhvillohen në përputhje me planet mësimore dhe dokumentohen në regjistrat elektronikë zyrtarë të sekretarive mësimore.
c) Materialet teorike sugjerohet të kenë të përcaktuara çështjet/pikat kryesore, si dhe fjalë/terma kyç, që i referohen faqeve të literaturës së miratuar në programet lëndore (syllabuset).
d) Kur leksionet ngarkohen në platformë me regjistrim, personeli akademik i paraqet në ditën e përcaktuar në orarin mësimor në mënyrë të përjavshme dhe i lë hapësirë studentëve për pyetje te ndryshme me shkrim.

- Në format e transmetimit të njohurive teorike mund të përdoren mënyra të tjera alternative, si prezantime apo shpjegime të:

e) Ushtrimeve tip, mënyra/modele zgjidhje të ushtrimeve, çështjeve, materialeve ilustruese (imazhe, video, projekte, etj.), të shkruara, të zgjidhura apo treguara nga pedagogu, ose të shpjeguara me tabelë, fletë ose dhe material tjetër mësimor (sipas zgjedhjes së vetë pedagogut) të regjistruar për çdo leksion dhe që në vazhdimësi do të shërbejnë për të vlerësuar të nxënit nga studenti.
f) Ushtrimet i referohen të gjithë materialit teorik mësimor, janë tipike dhe didaktike, duke iu referuar faqeve në literaturën e detyrueshme ose literaturën e rekomanduar.
g) Ushtrimet, çështjet, modelet praktike mund të përdoren gjatë komunikimeve të drejtpërdrejta ose të jepen në fund të leksionit si detyrë për zgjidhje nga studentët.
h) Ushtrimet mund të korrigjohen nga pedagogu më pas, të diskutohen me klasën në fillim të leksionit/komunikimit të drejtpërdrejtë të radhës.
i) Disa nga këto ushtrime mund/duhet të shërbejnë edhe për të vazhduar në leksionin/et e tjera (sipas specifikave të lëndës dhe të deklaruara me parë për studentët).

2.3 Realizimi i seminareve dhe ushtrimeve

- Seminaret dhe ushtrimet zhvillohen me *"Video Call"*. Studentët zhvillojnë të mësuarit ndërveprues, në disa forma si më poshtë:

a) Ushtrime të drejtuara nga pedagogët;
b) Ushtrime të zgjidhura nga studentët;
c) Diskutime bazuar në kërkesat e vetë studentëve për leksionin/et për pjesë atipike të tij ose shumë të rëndësishme;
d) Sqarime nga pedagogu dhe analiza nga studentët për temën/at;
e) Simulimi i ushtrimeve formuese;
f) Detyra kursi, projekte;
g) Vlerësimet e ushtrimeve formuese;
h) Laboratorë simulimesh;
i) Quizze vetëvlerësuese për temat e realizuara;
j) Konsulta të projekteve dhe detyrave të kursit;
k) Të tjera.

2.4 Realizimi i praktikave mësimore dhe orëve laboratorike

- Realizimi i praktikave mësimore dhe orëve laboratorike do të realizohet në përputhje me mundësitë dhe specifikat e secilit program studimi, me kërkesë të Njësisë Bazë dhe miratuar nga Dekani.

- Në pamundësi të realizimit të praktikës reale mësimore, të bëhet zëvendësimi me veprimtari të tilla si:
  a) Pjesëmarrje *online* në aktivitete të ndryshme në përputhje me profesionin;
  b) Analizë teksti;

c) Studim rasti;
d) Apo detyrë, tema e së cilës është në përputhje me fushën e interesit të praktikës profesionale të studentëve.

- Në pamundësi të gjetjes së një mënyre të përshtatshme për realizimin e praktikës mësimore dhe orëve laboratorike, kërkohet miratimi për realizimin e tyre në një kohë të dytë.

III. VLERËSIMI DHE PJESËMARRJA E STUDENTËVE

3.1 Procedurat e vlerësimit

- Vlerësimi i studentëve realizohet në përputhje me programet lëndore (syllabuset).
- Rezultatet e studentëve pasqyrohen në procesverbalin paraprak elektronik dhe rezervohen.

IV. SIGURIMI I CILËSISË

4.1 Ruajtja e standardeve të cilësisë

- Stafi akademik dhe administrativ angazhohen në ruajtjen e standardeve bazë të cilësisë gjatë procesit të mësimdhënies në distancë si më poshtë:

a) Pajisja e të gjithë personelit akademik, administrativ dhe studentëve me llogarinë e tyre në "Microsoft Teams" nga stafi IT i "Albanian University", përpara fillimit të procesit mësimor.
b) Mbështetja e të gjithë përdoruesve të "Albanian University" në aksesimin dhe përdorimin e platformës nga stafi i IT, gjatë gjithë procesit.
c) Njoftimi i studentëve të paktën një ditë përpara për ndryshimet eventuale në orarin mësimor të miratuar.
d) Ofrimi i procesit mësimor në distancë në format video dhe/ose audio duke i dhënë mundësi studentëve të jenë interaktiv.
e) Ofrimi i materialeve mësimore në platformë dhe lejimi i aksesit nga studentët gjatë gjithë vitit akademik.
f) Menaxhimi i klasës në distancë dhe mbajtja e komunikimit në standardet profesionale është përgjegjësi e personelit akademik.
g) Mbikëqyrja e realizimit të procesit mësimor nga Drejtuesi i Departamentit dhe nga strukturat përkatëse administrative në përfundim të çdo jave.
h) Arkivimi nga zyra e IT i çdo klase virtuale, si dhe i materialeve mësimore përkatëse, në përfundim të vitit akademik, duke lejuar në çdo kohë kontrollin për realizimin të tij.

4.2 Respektimi i syllabuseve dhe mbrojtja e të drejtave të autorit

- Të gjitha temat dhe materialet didaktike të përdorura për formën pasive dhe aktive të mësimit online, duhet të jetë në përputhje me syllabuset përkatëse.

- Materialet didaktike, dhe të tjera materiale të vëna në dispozicion nga pedagogët, përbëjnë të drejta të rezervuara të autorëve të tyre. Si rrjedhojë, përdorimi i tyre nga subjektet pjesëmarrës në procesin mësimor në distancë, jashtë qëllimit të këtij procesi, përbën shkelje të legjislacionit në fuqi, si dhe normave të kodit të Etikës së "Albanian University". Këshilli i Etikës së "Albanian University" mund të nisë procedim disiplinor për rastet e shkeljeve të Kodit të Etikës në lidhje me abuzimet e të drejtës së autorit.

V. Të tjera

- Mënyra e kryerjes së vlerësimit përfundimtar, për çdo cikël studimi, do të përcaktohet në një fazë të dytë, jo me vonë se 4 javë para mbylljes së procesit mësimor, në përputhje me Udhëzimet e MASR, si dhe në mbështetje të kalendarëve akademike.

Ky manual miratohet me Vendim Rektorati Nr. 2 **dt.** 02/11/**2020 dhe hyn në fuqi menjëherë.**